

në investime kapitale e arsyetojnë me kohën e realizimit të projekteve si dhe procedurat e prokurimit.

"Për shkak kushteve klimatike në fillim të vitit si dhe procedurat e prokurimit, të cilat marrin kohë, tek pas gjashtëmuorit të parë fillon realizimi i plotë i projekteve që kanë të bëjnë me investime kapitale. Por, tani jemi në vllugun më të madh të realizimit të këtyre projekteve dhe në fundit nuk do të ketë deficit të mjeteve që kanë të bëjnë me investime kapitale", ka thënë Ibrahim

Në këtë drejtim, sipas tij, edhe pasqyra financiare gjashtëmuore tregojnë se në shumë kategori të shpenzimeve që llogariten si shpenzime luksi, ka zvogëlim të shpenzimeve në krahasim me vitin paraprak. Ai ka thënë se komuna ka zvogëluar shpenzimet për telefoni mobile, për çfarë janë shpenzuar 590 euro më pak, pastaj në mobile për çfarë janë shpenzuar 9 mijë e 714 euro më pak, derivate për vetura ku janë shpenzuar 13 mijë e 656 euro më pak, dreka zyrtare ku shpenzimi është më i vogël se vitin e kaluar për

jekjet maksimale që kjo shkallë e inkasimit të rritet, pasi mundëson investime më të mëdha kapitale në lokalitete të ndryshme", ka thënë Aliu. Sipas statistikave që ofron pasqyra financiare e Komunës së Vitisë, nga 448 mijë euro të planifikuara si të hyra për gjashtëmuorin e parë të këtij viti, kjo komunë ka inkasuar 340 mijë euro, apo 76 për qind të mjeteve të planifikuara si të hyra vetjake. Në tatimin në pronë Komuna ka inkasuar 130 mijë euro nga 175 mijë euro sa kishte planifikuar.



KUVENDARËT SHUMICË HEQIN NJË PROJEKT PËR LIPJANIN, NXITEN REAGIME

Ekzekutivi heq projektin e rregullimit të trotuareve në Lipjan

Arian Duriqi

LIPJAN, 20 KORRIK - Me një propozim të ekzekutivit komunal, kuvendarët shumicë të pushtetit në Lipjan, në mbledhjen e fundit të KK-së, kanë aprovuar heqjen e një projekti të planifikuar më herët dhe me rëndësi për vetë qendrën e Lipjanit. Të menjëhershme kanë qënë reagimet e opozitës dhe të shoqërisë civile për këtë veprim. Për më tepër, me gjithë faktin se Lipjani aktualisht i ka në gjendje të mjerueshme shumicën e troturave gjatë rishikimit buxhetor në mbledhjen e fundit të KK-së, ekzekutivi ka hequr 70 mijë eurot e planifikuara një vit më herët dhe ato i ka ridestinuuar për një qëllim tjetër. E, ky veprim i ekzekutivit dhe i shumicës në KK, sipas nënkryetarit të PDK-së, Dega në

Lipjan, Florent Hoxha, vjen si dëshmi se kreu komunal, Imri Ahmeti dhe ekzekutivi i tij nuk e kanë prioritet Lipjanin si qendër në investime. "Planifikimi që ne si ekzekutiv e kemi bërë vitin e kaluar për rregullimin e trotuareve në Lipjan ka qënë planifikim emergjent dhe i nevojës së madhe, sepse disa nga trotuaret në qendër të Lipjanit e kanë gjendjen mjaft të keqe. Megjithatë, pamja e keqe në qendër nuk i ka penguar aspak kreut komunal dhe stafit të tij duke hequr këtë planifikim dhe duke dëshmuar se është qeverisje pa koncept dhe jo për qytetarin, por për interesa të ngushta personale", ka thënë Hoxha. Po kështu, edhe shoqëria civile në Lipjan ka reaguar në këtë plan. Bekim Krasniqi, drejtor

ekzekutiv në OJQ-në Youth Association for Human Rights (YAHR) e ka vlerësuar si gabim në hapa qëllimin e ekzekutivit për shmangie nga investimet në qendrën e Lipjanit. "Nuk ka justifikim asnjëherë lënia e qendrës së Lipjanit në gjendje të keqe, sidomos të trotuareve, dhe ridestinimi i mjeteve për diku tjetër. Qysh në vitin 2012 bashkë me mediet kishim dhënë alarmin për shkatërrimin e trotuareve në Lipjan, më pas ishte bërë planifikimi për këtë vit, mirëpo ky ekzekutiv e hoqi atë investim dhe kjo nuk është në interesin e qytetarëve. Trotuaret kanë pamje mjaft të keqe dhe kanë nevojë për investim", ka thënë Krasniqi. Në të vërtetë, rrumbullak dy vjet më parë kjo OJQ kishte ngritur shqetësimin

bazuar në faktin se në qendrën e Lipjanit nuk po kurseheshin trotuaret nga kompani të ndryshme ndërtimi. YAHR e identifikonte atëkohë këtë si një fenomen në rritje që po ndodhte në qytetin e Lipjanit dhe që njëherësh sillte rrezik për këmbësorët. "Fenomeni negativ që po ndodh në Lipjan ditëve të fundit është ai i shkatërrimit masiv të trotuareve për lëvizjen e këmbësoreve nëpër rrugët kryesore të qytetit dhe kjo po bëhet nga kompanitë e ndërtimit gjatë kycjeve të ndryshme në infrastrukturë. Me këtë rast po rrezikohen edhe këmbësorët gjatë lëvizjes së tyre nëpër qendër", kishte deklaruar Krasniqi, atëkohë. Pothuajse një vit më vonë ekzekutivi i atëhershëm i kësaj komune e kishte planifikuar rregullimin e tro-

tuareve për vitin 2014. Ndërkohë që, autoritetet komunale të Lipjanit në ditën e prezantimit të rishikimit buxhetor nuk e kanë komentuar shumë heqjen e 70 mijë eurove të destinuara për trotuare. Shkëlzen Hajdini, drejtor i Buxhetit dhe Financave, duke prezantuar para kuvendarëve vendimin mbi rishikimin e buxhetit për vitin 2014, ka thënë se për shkak të situatave të reja ekzekutivi detyrohet të heqë nga planifikimi rregullimin e trotuareve. Arsyetim për rishikimin buxhetor që është aprovuar me 20 vota pro, 9 kundër dhe një abstenim, janë përmendur obligimet e trashëguara nga vitet paraprake dhe rritja e pagave në shkallën prej 25 për qind për këtë vit buxhetor.

© KOHA Ditore

ADVANCED
HAIRCLINICS
MBJELLJE FLOKU

PRISHTINA INTERNACIONAL AIRPORT
DAILY FLIGHT SCHEDULE

Date: 21 Korrik July 2014

Home / Thursday

KOMPANIA AJRORE	NR.I	DESTINACIONI I	KOHA E	DESTINACIONI II	KOHA E
-----------------	------	----------------	--------	-----------------	--------

ORARI DITOR I FUTURIMEVE NE
AEROPORTIN NDERKOMBETAR TE PRISHTINES "ADEM JASHARI"
DAILY FLIGHT SCHEDULE OF
PRISHTINA INTERNATIONAL AIRPORT "ADEM JASHARI"

KOMPANIA AJRORE	NR.I	DESTINACIONI I	KOHA E	DESTINACIONI II	KOHA E
-----------------	------	----------------	--------	-----------------	--------